



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Numri i lëndës: 2021:264407  
Datë: 08.10.2024  
Numri i dokumentit: 06269068

**K.Dh.Sh.II.nr.530/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përbarimore të kreditorit “Raiffeisen Bank”, me seli në Prishtinë, rruga “Robert Doll” nr.99, kundër debitorëve 1.) “PROGROUP” Sh.p.k., me NRB:71006573, me seli në Prishtinë, lagjja “...” dhe 2.) I.F., me adresë në lagjen “...”, kundër debitorit “PROGROUP” Sh.p.k., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokat Hajzer Salihu, me bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.863/22 të datës 11.12.2023, me datë 08.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Raiffeisen Bank”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.863/22 të datës 11.12.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.863/22 të datës 11.12.2023, ne dispozitiv të aktvendimit

ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit "PROGROU" Sh.p.k., dhe Urdhri Përmbarrimor P.nr.328/2021 të datës 12.10.2021, i lejuar nga Përmbarruesi Privat Saranda Rexhepi, është shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës ,konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të anulohet vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.863/22 të datës 11.12.2023, dhe çështja të kthehet të rivendosje.

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Përmbarruesi privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përmbarrimor me të cilin ka lejuar përmbarrimin në bazë të dokumentit të besueshëm; Marrëveshja mbi Linjën e Kredisë për Kapital Punues nr.50007474/40011134, shtojca nr.2, nr.3 dhe nr.4 për Marrëveshjen mbi Linjën e Kredisë për Kapital Punues nr.40011134; t'i paguaj gjithsej borxhin në vlerë prej 31,871.09 €, me kamatë të rregullt dhe kamatëvonesa që do të arrij deri në pagesën definitive si dhe shumën e shpenzimeve të procedurës përmbarrimore në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij urdhri.

Kundër urdhrit përmbarrimor në afatin e paraparë ligjor prapësimi përmes të autorizuarit ka ushtruar debitori "PROGROU" Sh.p.k., ku ndër të tjera ka deklaruar se dokumenti në bazë të cilit është lëshuar urdhri nuk është origjinale ose kopje e vërtetuar andaj nuk i plotëson kushtet për përmbarrim. Tutje ka shtuar se kreditori nuk e ka vërtetuar faktin se debitori ka rënë në vonesë të përmbushjes së detyrimit si dhe nuk e ka respektuar thirrjen që duhet bere për përmbushjen ndaj debitorit siç parashihet me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimit. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar Gjykatës ta aprovoj prapësimin si të bazuar, shfuqizoj urdhrin përmbarrimor si dhe të obligohet kreditori që të mbuloj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Kreditori brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapsim ku ka deklaruar se prapësimi nuk është i bazuar në prova të cilat duhet te paraqiteshin me shkrim. Më tej ka shtuar se fillimisht i

ka shterur të gjitha mundësitë por pasi që debitori nuk ka shprehur gatishmëri në përmbushjen e detyrimit atëherë është iniciuar procedura përmbartimore andaj qëllimi i vetëm i debitorit është prolongimi i procedurës. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar Gjykatës ta refuzoj prapësimin e debitorit si dhe ta vërtetoj urdhrin përmbartimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim dhe shkresave në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.863/22 të datës 11.12.2023, me të cilin në dispozitiv të aktvendimit ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “PROGROUP” Sh.p.k., dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.328/2021 të datës 12.10.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Saranda Rexhepi, është shfuqizuar. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka vlerësuar se Marrëveshja mbi Linjën e Kredisë për Kapital Punues nr.50007474/40011134, shtojca nr.2, nr.3 dhe nr.4 për Marrëveshjen mbi Linjën e Kredisë për Kapital Punues nr.40011134, në bazë të cilave është mbështetur propozimi për përmbartim dhe është lejuar urdhri përmbartimor janë bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar siç kërkohet me nenin 36 të LPP-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se baza juridike për caktimin e përmbartimit, kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përmbartimin sipas dokumentit të përmbartimit, parashihen sipas dispozitës së nenit 36 par.1 të LPP-së, ku thuhet se “ *Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartushmërisë për përmbartushmëri*”, andaj në rastin konkret marrëveshja mbi linjën e kredisë për kapitalin

punues nr.50007474/40011134, shtojca nr.2,nr.3 për marrëveshjen mbi linjën e kredisë për kapital punues nr.40011134, si dhe konfirmimi i regjistrimit R-20190823-538 në bazë të cilës është mbështetur propozimi për përmbarim dhe është lejuar urdhëri përmbarimor janë bashkangjitur në kopje dhe se në shkresa të lëndës nuk gjinden origjinali apo kopja e vërtetuar, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Shkallës së Dytë i vlerësoi pretendimet ankimore të kreditorit se dokumentet përmbaruese konkretisht kontrata për pengun të vërtetuar e regjistruar pranë regjistrave publik është origjinal pasi që është lëshuar nga Ministria përkatëse mirëpo të njëjtat i refuzoj si të pa bazuar ngase të gjitha shkresat që gjinden në lëndë janë paraqitë në kopje e jo në origjinal ashtu sipas dispozitës së nenit 36 paragrafi 1 të LPP-së.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-DHOMA E SHKALLËS SË DYTË**

K.DH.SH.II nr.530/24 me datë 08.10.2024

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija Ymeri

Numri i lëndës: 2021:264407  
Datë: 08.10.2024  
Numri i dokumentit: 06269068